



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 140 prot.

Kamëz, më 29.09 2022

V E N D I M
Nr. 120 .Datë 29/09 2022
M B I

“NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 137 DATË 22.12.2021 ” PËR SISTEMIN E
TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 29.09.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.108 datë 29.09.2022 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 137 Datë 22.12.2021 ” Për Sistemin E Taksave Dhe Tarifave Vendore Në Bashkinë Kamëz ” Ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” Vendimit nr.5 datë 17.01.2022 të Këshillit Bashkiak Kamëz “Mbi krijimin, organizimin, dhe funksionimi e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike”, i ndryshuar me vendimin nr 160 datë 17.08.2022 “Mbi Ndryshimin në Vendimin nr.5 datë 27.01.2022 të Këshillit Bashkiak Kamëz për krijimin dhe organizimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Kamëz”; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtesë në Vendimin Nr. 137 datë 22.12.2021, “ Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz ”.
2. Përcaktimin e tarifave për m² të subjekteve tregtare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tregun Publik Kamëz, si vijon:
 - **Tarifë shfrytëzimi të hapsirës në Tregun Publik Kamëz, në vlerën 400 lekë/m²/muaj.**
3. Struktura e autorizuar për përdorimin e sipërfaqeve publike në tregje, të jetë Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Kamëz;
4. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife të jetë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

N/KR KËSHILLI

Ali DAUTI